

1. Titulli i projektaktit: Projektligji “Nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar
2. Audienca e synuar, lloji i konsultimit, metodat e konsultimit, mënyrat e komunikimit për njoftimin e konsultimit publik

Audienca e synuar	Lloji i konsultimit:	Metodat e Konsultimit	Mënyrat e komunikimit për njoftimin e konsultimit publik
	Projektakt	1. Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (http://ëëë.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/legjislacioni/projekt-akte) 2. Të ftuar në tryezë të rrumbullakët: - Z. Elton Stefani, STRAT KOM, Z. Perparim Tushaj, Consulting Alb,ITI, - Z. Fatmir Kazazi, Kazazi Consulting Sh.p.k.,Z. Lorent Gordi, PMI,External Affairs. - Znj.Brunilda Bakiri, BAT, Finanacë Z.Skënder Cini,BAT, - Z. Alban Ujkashaj, Inter Distributon Services, Znj. Mira Pogaçi, Bashkimi Tregtar i Shqipërisë - Z. Roland Shuperka, Ekspert i pavarur për Duhanin, - Z. Shefqet Avdullau, Bal cig.Sh.p.k. - Z. Agim Tafili, 3T cigare elektronike, , Z.Emrush Krasniqi, Imperial Tabaco, - Z. Gerti karapici, Artist Lounge, t, Z. Armando Pellumbi, Agna Group.	1. Përmes faqes elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (http://www.shendetesia.gov.al/al/baza-ligjore/legjislacioni/projekt-akte) 2. Email për njoftimin e datës së tryezës së rrumbullakët

3. Kohështrirja e aktiviteteve të konsultimit (nga inicimi tek raportimi)

1. Dërgimi i komenteve në adresën elektronike sipas afateve të parashikuara në ligj
2. Katërmujori i parë i 2019: Dërgimi i Projektaktit pranë Këshillit të Ministrave.

4. Burimet e nevojshme

Burimet e nevojshme për realizimin e konsultimit jannë:

A) Lidhur me organizimin e tryezës së rumbullakët:

1. Burime njerëzore në dispozicion, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale:
 - a) Znj. Mira Rakacolli, Zv/Ministre;
 - b) Znj. Antoneta Njehrrëna, Drejtore e Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator;
 - c) Znj. Ketrin Zeno, Përgjegjës i Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Shëndetësinë.
2. Bazë Materiale
 - a) Salla e Mbledhjeve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

5. Mbledhja e përgjigjeve

Në tryezën e konsultimit u prezantua projektligji dhe risitë që sjell.
u sugjeruan komente si më poshtë:

1. Bashkimi Tregtar i Shqipërisë

Tregtia e duhanit ka nevojë për inspektim të vazhdueshëm në zonat e ashtuquajtura “gri” si ambulantet, tezgat dhe tregjet e shumices, në mënyrë që të realizohet shitje me e kontrolluar e produkteve, por në asnjë mënyrë nuk mendojmë se licensimi i limituar, dhe as heqja e

nje produkti te ligjshem nga tregu, do te mund te ndikojte pozitivisht ne arritjen e synimit per MShMS-ne, ne klimen e biznesit e ate sociale.

Keto masa jane te parakohshme dhe te papershtatshme per vendin tone.

Ne perfundim konsideroni si me poshte:

a) Heqjen e detyrimit per licencim të pikave të shitjes (paragrafi 2 i Nenit 2)

b) Heqjen e Nenit 3 të projektligjit për ndalimin e shitjes së paketave me 10 cigare.

2. Përfaqësia e Distributorëve të Duhanit në Shqipëri

a) të hiqet paragrafi 2 i Nenit 2

b) Mbi nenin 3;

- autoritetet tatimore dhe doganore, përfshirë inspektoriatet e tjera ligjzbatuese, duhet të punojnë më shumë për të kontrolluar territorin dhe për zbatuar ligjet aktuale.
- Cilat janë kriteret që një pikë shitjeje duhet të plotësojë për t'u pajisur me licencën e cigareve
- Cila do të jetë marrëdhënia e këtyre pikave shitëse me kompanitë që tregtojnë cigare në tregun shqiptar.
- A ka ndonjë mendim të qarte se sa do të jete numri i pikave që do të licencohen për shitje cigaresh.
- janë të mendimit se miratimi i këtij neni do të sjellë ulje të ndjeshme të shitjeve të kompanive të cigareve dhe do të rrisë sasinë e shitjeve kontrabandë duke patur ndikim të drejtpërdrejtë të të ardhurat e buxhetit të shtetit për arsyen se ato pika shitjeje që nuk do të licenshen do të mundohen të ruajnë xhiron dhe fitimet e tyre duke shitur paketa kontrabandë, kjo pasi një pjesë e madhe e pikave të shitjes janë në zonat rurale dhe është pothuajse e pamundur të kontrollohen sic duhen.
- Sugjerojnë se, pa i dhënë zgjidhje pikave të shitjes që tregtojnë duhan të hapur, me Kg, apo me cigare që mbushen në mënyrë artizanale, miratimi i këtij ligji nuk do të ketë asnjë vlerë pasi këto lloj produktesh që shiten në mënyrë dhe në kushte aspak të pershtatshme janë shumë herë më të rrezikshme për shëndetin e duhanpirësve, sesa cigaret e prodhuara në mënyrë të kontrolluar. Gjithashtu në Nenin 2:
- Sa kohë para janë të detyruar prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të duhanit të lajmërojnë Ministrinë e Shëndetësisë, për lancimin e një kodi të ri?
- Cfarë të dhënash duhet të dërgohen specifikisht? Gjithashtu në Nenin 3
- Cfarë synohet me miratimin e këtij neni?
- A ka ndonjë studim për të treguar se çfarë ndikimi do të ketë tek konsumatorët?
- Pra sa është numri i duhanpirësve që konsumojnë produkte të tilla?

Sipas të dhënave të komentuesit, numri i duhanpirësve që konsumojnë cigare me shije dhe/ose aroma tëndryshme , është shumë i pakët dhe mendojmë se nuk do të ketë asnjë ndikim në uljen e numrit total të duhanpirësve. Kjo pasi ndalimi i shitjeve në treg i këtyre lloj cigareve, nuk do të thotë që duhanpirësit do të lënë automatikisht cigaren dhe se nuk do të gjejnë një zgjidhje tjetër alternative.

Gjithashtu në Nenin 4

- Nëse ky nen miratohet, nënkuptojmë se nuk do të ketë më paketa të dukshme në raftet e pikave të shitjes?

3. ConsultingAlb propozojnë:

Neni 1: 9

Duhan kaush/për tu dredhur nënkupton duhanin e grirë në fije të imta që përdoret për të bërë cigare nga konsumtorët pa përpunim të mëtejshëm industrial.

Përkufizimi i termit është bazuar në direktivën e BE.

Neni 1: 11.

Neni 1: 11. “Puro ose puretë” nënkupton një mbështjellje me gjethe duhani për pirje që konsumohet nëpërmjet procesit të djegies.

Propozojme të hiqet fjala nga duhani natyral pasi nga eksperiancat puretat mund të prodhohen dhe me zëvendësues të duhanit.

Neni 1, pas paragrafit 23

Propozim: të shtohet përcaktimi:

"shije karakteristike" nënkupton një shije apo erë të dallueshme nga ajo e duhanit, si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë duke përfshirë, por pa u limituar vetëm në to, frutat, barishte, alkool, sheqerëra, mentol ose vanilje; të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.

Qëllimi është të mos ketë vend për keqinterpretim të shijeve karakteristike.

Në nenin 8 pas paragrafit të parë të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë, për produktet e reja të duhanit. Ky lajmerim duhet dorëzuar në formë elektronike, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë:

- informacion kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri;
- një përshkrim i detajuar i produktit,
- instruksionet e lidhura me përdorimin e tij,
- listën e përbërësve të produktit,

materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.

Qëllimi ka qenë përcaktimi më i detajuar i përmbajtjes së njoftimit për produktet e reja.

Paragrafi i dytë i nenit 2, që parashikon paisjen me licensa të veçanta, mendojmë është i parkohëshëm për kushtet e Shqipërisë, dhe vecse do të rrisë tregëtinë e paligjëshme. Eksperienca në shumë vende (psh Hungaria, etj), ka treguar se liçensat janë shitur shumë herë më shtrenjt në tregun e zi dhe është rritur kontrabanda dhe tregëtia e paligjëshme në përgjithësi.

Në Shqipëri ka mbi 20 mijë pika shitje formale, përfshirë rrjetet e supermarketeve, bar-restorantet, etj. (pra që shesin produkte duhani të rregullta) dhe përsëri tregëtia e paligjëshme (shitjet në rrugë dhe në tregje të hapura) mbulon mbi 40% të konsumit.

Reduktimi i pikave formale të shitjes nëpërmjet liçensimit, nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të rrisë tregëtinë e paligjëshme, e cila përdor shitësa lëvizës, aplikon çmime më të ulta (pasi nuk paguan taksa) dhe shet mallra të pa kontrolluara, duke rritur më tej dëmet për shëndetin.

Paragrafi i dytë i nenit 2, që parashikon paisjen me licensa të veçanta, mendojmë është i parkohëshëm për kushtet e Shqipërisë, dhe vecse do të rrisë tregëtinë e paligjëshme. Eksperienca në shumë vende (psh Hungaria, etj), ka treguar se liçensat janë shitur shumë herë më shtrenjt në tregun e zi dhe është rritur kontrabanda dhe tregëtia e paligjëshme në përgjithësi.

Në Shqipëri ka mbi 20 mijë pika shitje formale, përfshirë rrjetet e supermarketeve, bar-restorantet, etj. (pra që shesin produkte duhani të rregullta) dhe përsëri tregëtia e paligjëshme (shitjet në rrugë dhe në tregje të hapura) mbulon mbi 40% të konsumit.

Reduktimi i pikave formale të shitjes nëpërmjet liçensimit, nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të rrisë tregëtinë e paligjëshme, e cila përdor shitësa lëvizës, aplikon çmime më të ulta

(pasi nuk paguan taksa) dhe shet mallra të pa kontrolluara, duke rritur më tej dëmet për shëndetin.

Eshte pranuar sugjerimi ne projekligjin e propozuar eshte hequr licensimi I pikave te shitjes.

Neni 3

Mendojmë të hiqet

Ligji aktual e rregullon shumë mirë shitjen e duhanit.

Por në praktikë ai nuk zbatohet as në pikat e rregullta të shitjes dhe aq më tepër në ato ilegale ku shiten cigare me fije, me çmime shumë të ulta, si edhe paketa me 20 cigare me çmim 50 lekë paketa (pra me çmim 2-3 herë më të larë edhe se paketat e rregullta me 10 fije). Në këto kushte kjo masë, nuk do t'ja arrijë qëllimit dhe do të ndihmojë orientimin e mëtejshëm të tregut rreth tregëtisë së paligjëshme.

Referuar ketij sugjerimi eshte vendour qe kjo dispozite te hyje ne fuqi 24 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Neni 4

Mendojmë të hiqet

Ne mendojmë që neni 13 i ligjit aktual (më poshtë), është mëse i qartë dhe propozimi i bërë mund të rrisë abuzimet e inspektorëve të kontrollit në terren.

Neni 5

Mendojmë të hiqet

Mendojmë ka ardhur koha që të analizohen me kujdes të gjitha produktet alternative, sidomos produktet pa djegje. Është e provuarshkencërisht se nga djegja e duhanit çlirohen më shumë se 7000 elementë kimikë të dëmshme ose potencialisht të dëmshme. Gjithnjë e më shumë, veçanërisht në vendet e zhvilluara, po futen produkte alternative pa djegje, përfshirë duhanin me ngrohje dhe cigaret elektronike, që konsumohen pa djegje por nëpërmjet ngrohjes dhe që nuk gjenerojnë tym.

Këto produkte (të prodhuara dhe certifikuara konform standarteve ndërkombëtare) kanë dëme 90-95% më të ulta se produktet e duhanit me djegje (cigaret tradicionale) dhe duke mos gjeneruar tym nuk dëmtojnë personat e tjerë në ambjentet e mbyllura. Ju lutemi referojuni për këtë problem certifikimeve dhe publikimeve të bëra nga organet e shëndetit publik të Anglisë, Japonisë, Gjermanisë, Zvicrës, etj.

Neni 6 dakord.